Nr. 3078/3 Prot. Tiranë, më 29.03.2019

Nr. Identifikimi 252 Vendimi 14

# REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi juridik:** **"NELI" sh.p.k.**
**Nr. NIPT-i:** J68103906N
**Adresa e selisë:** lagjja "Pjeter Budi", banese private 50 metra ne krah te Albtelekomit Mat, Burrel, Diber
**Personi përgjegjës:** Isuf Neli

Për të zhvilluar projektin **"Shfrytëzim i mineralit të kromit".**
Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, ''Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis'', Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** objektin e kromit "Galeria 7 dhe galeria 3/2", Bashkia Bulqize, qarku Dibër

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**
*Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

- Subjekti nuk ka marrë parasysh kërkesat e drejtorive teknike të Ministrisë në fazën e njoftimit në lidhje me mbetjet.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, ***në rast se*** zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

***Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura, shprehet:***

Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti i subjektit "NELI" sh.p.k. ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek asnjë Monument Natyre.

**2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

Në përshkrimin e paraqitur, nuk janë detajuar masat mbi mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj… të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT TIRANË

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**



Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë. www.akm.gov.al Tel/Fax 04 2 371 237

## Aneksi 1. Harta me koordinatat

